



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS  
FONETIKË E GJUHËS B

**Ngarkesa:** 4 kredite ; 40 orë mësimore; 15 leksione; 25 seminare.

**Viti akademik:** Viti I, semestri II

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

Kjo lëndë është një hyrje në disiplinat shkencore të Fonetikës dhe Fonologjisë që merren me studimin e tingujve të gjuhës njerëzore si nga pikëpamja e nyjëtimit dhe perceptimit të tyre, ashtu edhe nga pikëpamja funksionale. Konceptet kryesore të Fonetikës dhe Fonologjisë do të studiohen me fokus në gjuhën greke.

*Objektivat e përgjithshme lëndore:* T'i pajisë studentët me njohuritë teorike bazë të Fonetikës dhe Fonologjisë. Të jenë në gjendje të përcaktojnë karakteristikat (fizike dhe nyjëtimore) të tingujve të gjuhës së folur. Të studiojnë funksionin tyre si njësi gjuhësore, dmth mënyrën sesi tingujt organizohen brenda sistemit gjuhësor për të dalluar kuptimet e fjalëve.

*Objektivat e specifike lëndore:*

Përshkrimi i mekanizmit të të folurit dhe nyjëtimit të tingujve të gjuhës greke, njohja me Alfabetin Ndërkombëtar të Fonetikës dhe sistemin e transkriptimit fonetik. Dallimi mes fonemave dhe alofoneve, njohja e rregullave fonologjike, strukturës së rrokjes, proceseve fonologjike.